



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1278/1 prot.

Tiranë më 20.10.2020

Lënda: Mendim mbi dy dokumente

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 16/34 prot., datë 19.10.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim “*Marrëveshjen mbi Sigurinë e Ndërlidhjes ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Departamentit të Shteteve të Bashkuara për Sigurinë e Brendshme dhe Mbrojtjen e Kufijve dhe Doganave, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës*” dhe “*Marrëveshjen mbi Sigurinë e Ndërlidhjes I ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Doganave dhe Mbrojtjes së Kufijve të SHBA-ve për Sistemin e Avancuar të Informacionit për pasagjerët (APTIS)/Sistemin e Automatizuar të Targetimit (ATS) dhe Sistemin e Automatizuar të Targetimit – Global (ATS-G)*”, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në tërësi, i vlerëson këto akte konform ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar.

Nga ana tjetër, meqenëse aktet në fjalë parashikojnë transferim ndërkombëtar të dhënash personale, në një frekuencë të vazhdueshme dhe eventualisht të lartë, Zyra e Komisionerit rekomandon t’i kushtohet një vëmendje e posaçme ngritjes, administrimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit, në përputhje me standardet ligjore dhe teknike-organizative, të parashikuara në aktet nënligjore të Komisionerit.

Konkretisht, në udhëzimin nr. 47, datë 14.09.2018 “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” në harmoni me nenin 5 të udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018 “*Për çertifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre*”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



KOMISIONERI

Besnik Dervishi